



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.150

10 nëntor

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr.7143 datë 28.10.2011	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	6917
Vendim i KM nr.692, datë 18.10.2011	Për një shtesë në vendimin nr.1719, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”.....	6917
Vendim i KM nr.693, datë 12.10.2011	Për licencimin e Akademisë së Studimeve të Aplikuara, Durrës.....	6918
Vendim i KM nr.694, datë 5.10.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.825, datë 28.12.2005 të Këshillit të Ministrave “Për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Statistikave”, të ndryshuar.....	6919
Vendim i KM nr.695, datë 5.10.2011	Për caktimin e datës së krijimit të Shërbimit Informativ Ushtarak...	6919
Vendim i KM nr.697, datë 12.10.2011	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.5.2011 për çështjen nr.26866/05 “Shkalla kundër Shqipërisë”.....	6920
Vendim i KM nr.698, datë 12.10.2011	Për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për 8 bashki dhe 10 komuna.....	6920
Vendim i KM nr.699, datë 12.10.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Lefter 1, 2, 3” dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë.....	6921
Vendim i KM nr.700, datë 12.10.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Iballë 1, 2, 3” e “Sapaç 1, 2” dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë.....	6922

Vendim i KM nr.701, datë 28.9.2011	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentraleve mbi kaskadën e lumit Osum, si propozim i kërkuar.....	6922
Udhëzim i MB nr.394, datë 3.11.2011	Mbi procedurat e pajisjes me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë.....	6923
Vendim i BSH nr.70, datë 12.10.2011	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka Credins sh.a.....	6926
Vendim i BSH nr.71, datë 12.10.2011	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Dega e Bankës Alpha-Albania/Alpha Bank-Albania.....	6926
Vendim i KKRT nr.235, datë 3.10.2011	Për dhënie licence për televizionin privat vendor “Tv Adria Med”.	6927
Vendim i KKRT nr.236, datë 3.10.2011	Për dhënie licence për televizionin privat vendor “Tv Best”.....	6927
Vendim i KKRT nr.237, datë 3.10.2011	Për zgjerim zone licencimi për televizionin privat kabllor “APT”...	6928
Vendim i KKRT nr.238, datë 3.10.2011	Për dhënie licence për televizionin privat kabllor “CA -Tv Përmet”.....	6929
Vendim i KKRT nr.240, datë 3.10.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “Tv kabllor Fokus”.....	6929
Vendim i KKRT nr.241, datë 3.10.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Telesport”.....	6930
Vendim i KKRT nr.242, datë 3.10.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Sot 7”.....	6930
Vendim i KKRT nr.243, datë 3.10.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Boom Boom Radio”.....	6931
Vendim i KKRT nr.244, datë 3.10.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Alpo”.....	6931
Vendim i KKRT nr.245, datë 3.10.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv M+”.....	6932
Vendim i KKRT nr.246, datë 3.10.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Aldo 03”.....	6932
Vendim i KKRT nr.247, datë 3.10.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Star”.....	6933
Vendim i KKRT nr.248, datë 3.10.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio 7”.....	6933

Vendim i KKRT nr.249, datë 3.10.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv ABC News”	6934
Vendim i KKRT nr.250, datë 3.10.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv 6”	6934
Vendim i KKRT nr.251, datë 3.10.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Amantia”	6935
Vendim i KKRT nr.258, datë 3.10.2011	Mbi pavlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Armonia”	6935
Vendim i KKRT nr.259, datë 3.10.2011	Mbi pavlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Gramshi”	6936
Vendim i KKRT nr.260, datë 3.10.2011	Mbi pavlefshmërinë e licencës së subjektit radiofonik privat me përsëritës “Radio Italia”	6937
Vendim i KKRT nr.261, datë 3.10.2011	Mbi pavlefshmërinë e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio ABC”	6938
Vendim i KKRT nr.262, datë 3.10.2011	Mbi mosrinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “Tv kabllor Poliçani”	6939
Vendim i ERE nr.95, datë 30.9.2011	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Hec-Ulëz Shkopet” sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Ulëz” dhe hec “Shkopet”	6941
Vendim i ERE nr.96, datë 30.9.2011	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Hec-Ulëz Shkopet” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.	6942
Vendim i ERE nr.97, datë 30.9.2011	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec Bistrica 1 dhe hec Bistrica 2.....	6943
Vendim i ERE nr.98, datë 30.9.2011	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Hec Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.p.k. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike	6944

DEKRET
Nr.7143, datë 28.10.2011

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, të nenit 9 pika 7 dhe nenit 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Muhammet Hilmi Aksoy
2. Abdülmennan Hilmi Aksoy
3. Abdülaziz Hilmi Aksoy

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bamir Topi

VENDIM
Nr.692, datë 18.10.2011

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.1 719, DATË 17.12.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ANKANDIT PUBLIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 45 të ligjit nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregullat e ankandit publik, miratuar me vendimin nr.1719, datë 17.12.2008 të Këshillit të Ministrave, në kreun II “Rregullat e përgjithshme të ankandit”, pas pikës 2.2 shtohet pika 2.2/1, me këtë përmbajtje:

“2.2/1. Në rastin kur objekti i ankandit përbëhet nga skrape të çfarëdolloj natyre, në përlllogaritjen e vlerës fillestare monetare të ankandit, komisioni i posaçëm i vlerësimit duhet të bazohet, përveç sa parashikohet në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2.1, edhe në mesataren e çmimit të bursave ndërkombëtare për kategoritë përkatëse të skrapit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.693, datë 12.10.2011

PËR LICENCIMIN E AKADEMISË SË STUDIMEVE TË APLIKUARA, DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 2, 43, 44 dhe 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e Akademisë së Studimeve të Aplikuara, Durrës, në emër të shoqërisë “Talenti”, sh.p.k., e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Durrësit.
2. Akademia e Studimeve të Aplikuara, Durrës, do të organizohet në katër fakultete:
 - a) Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, që do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë në:
 - i) Menaxhim biznesi;
 - ii) Financë.
 - b) Fakulteti i Shkencave të Edukimit, që do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë në:
 - i) Mësuesi për arsimin fillor;
 - ii) Mësuesi për arsimin parashkollor.
 - c) Fakulteti i Shkencave Shoqërore, që do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë në drejtësi.
 - ç) Fakulteti i Shkencave Mjekësore, që do të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë në infermieri.
3. Akademia e Studimeve të Aplikuara, Durrës të ofrojë programet e studimit të ciklit të parë, me kohëzgjatje 3 (tre) vite akademike dhe me realizimin e, së paku, 180 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë e nivelit të parë “Bachelor” në:
 - a) Menaxhim biznesi;
 - b) Mësuesi për arsimin fillor;
 - c) Mësuesi për arsimin parashkollor;
 - ç) Financë;
 - d) Drejtësi;
 - dh) Infermieri.
4. Akademia e Studimeve të Aplikuara, Durrës ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 3 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës. Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.
5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
6. Akademia e Studimeve të Aplikuara, Durrës, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.
7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.694, datë 5.10.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.825, DATË 28.12.2005 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË STATISTIKAVE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 10 të ligjit nr.9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare” dhe të nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.825, datë 28.12.2005 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në listën e anëtarëve të Këshillit të Statistikave, z.Etion Kapedani zëvendësohet me z.Florian Nuri.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.695, datë 5.10.2011

PËR CAKTIMIN E DATËS SË KRIJIMIT TË SHËRBIMIT INFORMATIV USHTARAK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e datës 11 dhjetor 1991 si datën e krijimit të Shërbimit Informativ Ushtarak.
 2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.697, datë 12.10.2011

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 10.5.2011 PËR ÇËSHTJEN NR.26866/05 “SHKALLA KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.5.2011, për çështjen nr.26866/05 “Shkalla kundër Shqipërisë”, në shumën 4 000 (katër mijë) euro, si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin, në masën 10 për qind të kësaj shume.
2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati përfundimtar për kryerjen e ekzekutimit është data 10.11.2011.
3. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
4. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit, z.Ardian Shkalla dhe të konvertohet në lekë me kursin e këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.
5. Pagimi i shumës së depozituar sipas pikës 4 të këtij vendimi, në favor të ankuesit, z.Ardian Shkalla, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.
6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.698, datë 12.10.2011

PËR KOMPENSIMIN E VLERËS SË TAKSËS SË BIZNESIT TË VOGËL, TË PËRDORUR PËR RIMBURSIMIN E PAJISJEVE FISKALE E TË TAKSIMETRAVE, PËR 8 BASHKI DHE 10 KOMUNA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e vlerës së pajisjeve fiskale e të taksimetrave, për njësitë e qeverisjes vendore, për 8 (tetë) bashki dhe 10 (dhjetë) komuna, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Fondi, në vlerën 37 720 925 lekë (tridhjetë e shtatë milionë e shtatëqind e njëzet mijë e nëntëqind e njëzet e pesë) lekësh, përballohet nga Fondi i Kontigjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2011.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

Nr.	Emri i NJQV-së	Vlera (në lekë)
1	Bashkia Kuçovë	3,233,100
2	Bashkia Rrëshen	4,311,250
3	Bashkia Bilisht	3,184,500
4	Bashkia Peqin	864,295
5	Bashkia Fier	18,244,500
6	Bashkia Patos	3,315,100
7	Bashkia Çorovodë	576,000
8	Bashkia Korçë	485,625
9	Komuna Papër	466,930
10	Komuna Bupq	382,000
11	Komuna Ishëm	604,531
12	Komuna Udënisht (Pogradec)	112,000
13	Komuna Q.Bulgarec	470,775
14	Komuna Zharrëz	618,750
15	Komuna Perondi	226,834
16	Komuna Mollas	20,486
17	Komuna Kozarë	251,250
18	Komuna Qendër (Fier)	352,999
	Shuma	37,720,925

VENDIM
Nr.699, datë 12.10.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË
HIDROCENTRALEVE “LEFTER 1, 2, 3” DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN
PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3 e 23, pika 3 shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentraleve “Lefter 1, 2, 3”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin, teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar) për dhënie me koncesion të këtyre hidrocentraleve, që i jepet shoqërisë “AS COLOR” sh.p.k.



3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Lefter 1, 2, 3” të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.700, datë 12.10.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË
HIDROCENTRALEVE “IBALLË 1, 2, 3” E “SAPAÇ 1, 2” DHE MIRATIMIN E BONUSIT NË
PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE QË I JEPET SHOQËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3, shkronja “b”, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentraleve “Iballë 1, 2, 3” dhe “Sapaç 1, 2” është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2% të pikëve për rezultatin, teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar) për dhënien me koncesion të këtyre hidrocentraleve, që i jepet shoqërisë “Energy Finance Management Shqipëria” sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën konkurruese përzgjedhëse për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Iballë 1, 2, 3” dhe “Sapaç 1, 2” të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të skemës, ku përfshihet ndërtimi i këtyre hidrocentraleve.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.701, datë 28.9.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË
HIDROCENTRALEVE MBI KASKADËN E LUMIT OSUM, SI PROPOZIM I KËRKUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, 9 e 16 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentraleve mbi kaskadën e lumit Osum, si propozim i kërkuar, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.394, datë 3.11.2011

MBI PROCEDURAT E PAJISJES ME PASAPORTË BIOMETRIKE TË SHTETASVE SHQIPTARË

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, ligjit nr. 9972, datë 28.7.2008 “Për ratifikimin e “Kontratës koncesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike” ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit të SAGEM Securite dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”, si dhe nenit 6 të ligjit nr.8668, datë 23.11.2000 “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar,

Me qëllim unifikimin dhe standardizimin e procedurave që ndiqen nga zyrat e gjendjes civile, kompania “ALEAT”, strukturat e Policisë së Shtetit, për pajisjen e shtetasve me pasaportë biometrike, në funksion të parandalimit të veprimtarisë kriminale që lidhet me falsifikimin, shpërdorimin e detyrës etj. dhe të vënies para përgjegjësisë ligjore të personave përgjegjës,

UDHËZOJ:

1. Shtetasit shqiptarë aplikojnë për pasaportë biometrike në zyrat e gjendjes civile pranë bashkive/komunave/njësive bashkiake ku ndodhet regjistri themeltar i shtetasit që do të aplikojë dhe duhet të kenë me vete një fotografi me përmasa 4x5 cm, e cila vendoset nga punonjësi i gjendjes civile në formularin e aplikimit.

2. Punonjësi i zyrës së gjendjes civile i kërkon shtetasit/es aplikues për pajisjen me pasaportë biometrike, paraqitjen e dokumentit të identitetit ose certifikatës me fotografi për personat nën 16 vjeç dhe më pas fillon intervistën me shtetasin (mbi gjeneralitetet, apo të dhëna të tjera) dhe pasi bindet se është personi i njëjtë, i jep shtetasit formularin (vetëdeklarim i të dhënave personale) model 1, pjesë e këtij udhëzimi (i cili mbahet në dy kopje të njëjta), ku në prezencë të punonjësit të gjendjes civile shtetasi e plotëson formularin e vetëdeklarimit, duke vendosur të dhëna të sakta dhe duke e nënshkruar atë.

3. Punonjësi i zyrës së gjendjes civile, në prezencë të qytetarit, nëpërmjet të dhënave të formularit të vetëdeklarimit, bën verifikimin me të dhënat e regjistrit themeltar të gjendjes civile dhe në qoftë se ato rezultojnë të rregullta, vendos fotografinë në formular, bën vulosjen me vulën e gjendjes civile në anën e majtë të fotografisë dhe ciklimin: “Nga verifikimet në regjistrin e gjendjes civile rezulton se të dhënat e formularit të vetëdeklarimit janë të njëjta me ato të regjistrit të gjendjes civile dhe të vazhdojnë procedurat e aplikimit dhe pajisjes me pasaportë biometrike.”, duke e nënshkruar atë.

4. Punonjësi i zyrës së gjendjes civile për formularët e vetëdeklarimit, në çdo rast dërgon për verifikim brenda ditës në komisariatit e policisë, ku ka vendbanimin shtetasi aplikues, formularët e vetëdeklarimit për aplikimet e shtetasve të cilët kërkojnë të pajisen me pasaportë biometrike.



5. Komisaritet e policisë nëpërmjet ndihmës të specialistëve të hetimit dhe parandalimit të krimit, bëjnë verifikimin e shtetasit sipas të dhënave të formularit të vetëdeklarimit, autentitetin e fotografisë së vendosur në formular dhe nëse i gjen të rregullta, bën ciklimin: “Nga verifikimet nëpërmjet burimeve të ndryshme apo i kontaktuar me shtetasin, rezulton se të dhënat dhe fotografia e shtetasit në formular i përkasin të njëjtit shtetas.”, e nënshkruar prej tij, dhe nëpërmjet sekretarisë, në krahun e djathtë të fotografisë, vendoset vula e komisaritetit të policisë.

6. Gjatë verifikimit punonjësi i policisë, nëpërmjet numrit të telefonit të vendosur nga shtetasi në formularin e vetëdeklarimit apo me njoftime të tjera, kur ka dyshime, për sqarim mund të thërrasë shtetasin në organin e policisë, i cili është i detyruar që t’i përgjigjet thirrjes së policisë për t’u paraqitur dhe të japë sqarimet e kërkuara nga policia.

7. Në rastet kur punonjësi i policisë, nëpërmjet burimeve të informacionit edhe nga mos paraqitja e shtetasit, kur ai e ka bërë njoftimin e tij dhe bëhet e pamundur verifikimi i tij, ai bën ciklimin: “Nga verifikimet e bëra nuk është bërë i/e mundur verifikimi i shtetasit i cili edhe pas njoftimit të policisë me telefon dhe njoftimit verbal, nuk u paraqit.”, bën njoftimin e zyrës së gjendjes civile, për pezullimin e procedurave të aplikimit, ndërsa formularin e vetëdeklarimit, me shpresë përcjellëse ia dërgon sektorit kundër krimit financiar në drejtorinë e policisë së qarkut, për hetime të mëtejshme, për veprën penale për falsifikim të dokumentit zyrtar, në bazë të nenit 186 të Kodit Penal.

8. Në rast se nga verifikimi rezulton se të dhënat e shtetasit me fotografinë e vendosur në formular nuk janë të rregullta, dokumentet bllokohen duke përpiluar një procesverbal konstatimi dhe i dërgohen me shpresë sektorit kundër krimit financiar në drejtorinë e policisë së qarkut për hetime të mëtejshme, për veprën penale për falsifikim të dokumentit zyrtar, në bazë të nenit 186 të Kodit Penal.

9. Formularët e vetëdeklarimit të verifikuar, komisariteti i policisë i dërgon me shpresë përcjellëse të listuar, të firmosur e të vulosur nga shefi i komisaritetit të policisë brenda tre ditëve, në zyrat e gjendjes civile për fillimin e procedurave të aplikimit dhe pajisjes me pasaportë biometrike dhe brenda 24 orëve për formularët e vetëdeklarimit për aplikimet me emergjencë.

10. Punonjësi i zyrës së gjendjes civile, pas konfirmimit zyrtar të bërë nga komisariteti i policisë për identifikimin e gjeneraliteteve të shtetasit aplikant, përcaktuar në pikën 9 të këtij udhëzimi, pajis shtetasin me dokument (certifikatë personale) bashkëlidhur kopje të formularit të vetëdeklarimit të shtetasit, i cili paraqitet në zyrën e aplikimit të shoqërisë kontraktuese “ALEAT” për t’u pajisur me pasaportë biometrike.

11. Punonjësit e policisë, në pikat e kalimit dhe kontrollit kufitar (PKKK), në rastet kur gjatë kontrollit apo intervistimit të shtetasve të cilët hyjnë apo dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë, konstatojnë pasaporta me të dhëna apo fotografi të falsifikuara, bëjnë menjëherë bllokimin e pasaportës dhe shoqërimin e shtetasit për veprime të mëtejshme nga strukturat e specializuara të drejtorisë rajonale të kufirit dhe migracionit dhe të drejtorisë së policisë qarkut.

12. Shtetasit të cilëve i humb/vidhet apo bëhet e papërdorshme pasaporta biometrike, bëjnë denoncim me shkrim në komisaritetin e policisë, i cili kryen të gjitha veprimet e nevojshme për verifikimin e rrethanave të këtij fakti dhe të autorësisë së mundshme. Komisariteti i policisë, brenda tre ditëve nga marrja e denoncimit për humbje/vjedhje, pajis me vërtetimin e deklarimit të humbjes shtetasin. Mënyrat e marrjes së denoncimit dhe procedurat e pajisjes së shtetasit me vërtetim rregullohen me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

13. Formulari, model 1, pjesë e këtij udhëzimi, pasqyron këto të dhëna:

Emër, mbiemër, atësia, mëmësia, datë, muaji, viti i lindjes, vendbanimi, adresa e saktë dhe numri i telefonit. Formulari plotësohet me germa shtypi dhe shkrim të lexueshëm në dy kopje.

14. Dokumentacioni, formulari model 1, pjesë e këtij udhëzimi, dhe certifikata ruhen në arkivën e zyrave të gjendjes civile me afat 10 (dhjetë vjet) nga data e plotësimit të pasaportës biometrike.

15. Ndalohet, pajisja e shtetasve me pasaportë biometrike pa iu nënshtruar procedurave të mësipërme.

16. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen zyrat e gjendjes civile në bashki/komuna, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

MODEL 1

FORMULAR VETËDEKLARIMI

Të dhënat e vetëdeklarimit dhe fotografia e shtetasit për t'u verifikuar nga zyra e gjendjes civile dhe Policia e Shtetit:



Emër, mbiemër		
Atësia /amësia		
Datëlindja		
Vendlindja		
Adresa e saktë e shtetasit		
Numri i telefonit		

Autorizim

Deklaroj se të dhënat e paraqitura nga ana ime në këtë formular _____ dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga zyrat e gjendjes civile dhe Policia e Shtetit.

DEKLARUESI

MARRËSI I VETËDEKLARIMIT

(Punonjësi i gjendjes civile)

Emër/mbiemër/firma

Emër/mbiemër/firma

Përgjigja e punonjësit të gjendjes pas verifikimit _____

Nënshkrimi, emër/mbiemër/firma

Data e nënshkrimit /ora

Përgjigja e punonjësit të policisë pas verifikimit _____

PUNONJËSI I POLICISË

Nënshkrimi, emër, mbiemër / firma

Data e nënshkrimit/ora

Shënim. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet nga punonjësit e zyrave të gjendjes civile dhe Policia e Shtetit.

Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale për falsifikim të dokumenteve zyrtare, në bazë të nenit 186 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.



VENDIM
Nr.70, datë 12.10.2011

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SHITESË
NGA BANKA CREDINS SHA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a”, nenit 43 shkronja “e”, të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 23 pikat 1 dhe 3, të nenit 24 pika 1 shkronja “ç”, të nenit 54 pika 2 shkronja “dh” nënpika “v”, të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga banka “Credins” sh.a., të veprimtarisë financiare shtesë, si më poshtë:

a) Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valuator, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, si më poshtë:

i) letra me vlerë të transferueshme.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të kryer ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës Credins sh.a., sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM
Nr.71, datë 12.10.2011

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SHITESË
NGA DEGA E BANKËS ALPHA-ALBANIA/ALPHA BANK-ALBANIA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a”, të nenit 43 shkronja “e”, të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 23 pikat 1 dhe 3, të nenit 24 pika 1 shkronja “ç”, të nenit 54 pika 2 shkronja “d”, të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Dega e Bankës Alpha-Albania/Alpha Bank-Albania të veprimtarisë financiare shtesë, si më poshtë:

- “Ofrimi i garancive dhe marrja e angazhimeve”.

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të kryer ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Degës së Bankës Alpha-Albania/Alpha Bank-Albania, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM
Nr.235, datë 3.10.2011

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT VENDOR “TV ADRIA MED”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “ADRIA MED” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Adria Med” sh.p.k. për t’u licencuar si operator televiziv privat vendor dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë shoqërisë “Adria Med” sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat vendor, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për të mbuluar me sinjal rrethin e Durrësit.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.236, datë 3.10.2011

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT VENDOR “TV BEST”
SUBJEKTIT: SHOQËRISË “TV BEST” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, dhe rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “TV Best” sh.p.k., për t’u licencuar si operator televiziv privat vendor dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit



VENDOSI:

1. T'i japë shoqërisë "TV Best" sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat vendor, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për të mbuluar me sinjal qarkun e Elbasanit.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.237, datë 3.10.2011

**PËR ZGJERIM ZONE LICENCIMI PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR "APT"
SUBJEKTIT PERSON FIZIK: ELTION THANASI**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll", miratuar me vendimin e KKRT-së, nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit, personit fizik z.Eltion Thanasi, për zgjerim zone licencimi dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit, person fizik, Eltion Thanasi, licencuar për subjektin televiziv privat kabllor "APT", sipas licencës nr.039/RTV kabllor, në qytetin e Himarës.

2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.

3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.238, datë 3.10.2011

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR “CA -TV PËRMET”
SUBJEKTIT PERSON FIZIK: ANDUEL SHABANI

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin e KKRT-së, nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit, person fizik z.Anduel Shabani, për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë licencë, personit fizik z.Anduel Shabani, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “CA-TV Përmet”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Përmetit.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.240, datë 3.10.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR “TV
KABLLOR FOKUS”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së, “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat kabllor “TV kabllor Fokus”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore kabllore.

2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet që nga data 30.5.2011 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati



VENDIM
Nr.241, datë 3.10.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV TELESPORT”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së, “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

